


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Shkurt 2022

**Tiranë, më 17 Mars 2022:** Në Shkurt 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 37 mld lekë, duke u rritur me 50,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 6,5 %, në krahasim me Janar 2022. Importet e mallrave arritën vlerën 69 mld lekë, duke u rritur me 31,5 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 24,9 %, në krahasim me Janar 2022. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 31 mld lekë, duke u rritur me 14,3 %, krahasuar me Shkurt 2021 dhe me 57,0 %, në krahasim me Janar 2022.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë dymujor eksportet e mallrave arritën vlerën 72 mld lekë, duke u rritur me 49,0 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 124 mld lekë, duke u rritur me 26,7 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 51 mld lekë, duke u rritur me 4,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Shkurt 2022, në rritjen e eksporteve prej 50,5 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +20,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +11,5 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me +9,2 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shkurt 2022**




Eksportet, gjatë këtij dymujori janë rritur me 49,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +22,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +10,6 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me +6,3 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Shkurt 2022, në rritjen e importeve prej 31,5 %, krahasuar me Shkurt 2021, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +11,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +6,9 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +4,5 pikë përqindje. Ndërsa grupi që ka ndikuar negativisht në rritjen e importeve është: “Të tjera” me -0,2 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shkurt 2022**



Si dymujor, importet janë rritur me 26,7 %, krahasuar me dymujorin e parë 2021. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +8,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +7,3 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +4,4 pikë përqindje.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Shkurt 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2021 janë: Itali (57,5 %), Kosova (57,9 %) dhe Gjermania (3,3 herë). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: SHBA (12,0 %), Turqia (41,9 %) dhe Spanja (90,0 %).

Gjatë këtij dymujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (47,4 %), Gjermania (3,3 herë) dhe Kosova (75,6 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Spanja (76,0 %) SHBA (8,7 %) dhe Turqia (38,1 %).

Në muajin Shkurt 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shkurt 2021 janë: Italia (21,0 %), Turqia (46,3 %) dhe Greqia (26,4 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: SHBA (39,9 %) dhe Ukraina (13,3 %).

Gjatë këtij dymujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (21,2 %), Turqia (52,1 %) dhe Kina (3,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: SHBA (25,6 %) dhe Zvicra (33,2 %).

**Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt 2022**



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 61,6 %, të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 55,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,2 %), Turqi (7,6 %), Gjermania (7,4 %), dhe Greqia (6,7 %).

Shkëmbimet tregtare, për dymujorin 2022, me vendet e BE-së zënë 61,7 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shkurt 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,7 %), Turqia (7,9 %), Gjermania (7,6 %) dhe Greqia (6,6 %).

**Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Shkurt 2022**

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2021		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	Janar-Shkurt 19	44	6,3	92	1,3	-47	48,4
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	Janar-Shkurt 20	48	8,0	94	1,9	-46	51,3
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	Janar - Shkurt 21	49	1,0	98	4,3	-49	49,7
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	Janar-Shkurt 22	72	49,0	124	26,7	-51	58,4

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Shkurt 2022

	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2021	Shkurt 2022	Jan, - Shkurt 2021	Jan, - Shkurt 2022	Shkurt 2021	Shkurt 2022	Jan, - Shkurt 2021	Jan, - Shkurt 2022
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>18.224</b>	<b>27.108</b>	<b>37.462</b>	<b>53.609</b>	<b>30.662</b>	<b>38.161</b>	<b>55.218</b>	<b>67.382</b>
Austri	164	402	295	697	409	603	804	1.065
Gjermani	973	3.161	2.060	6.885	4.243	4.685	7.371	7.984
Greqi	1.369	1.849	2.488	3.693	4.191	5.299	8.000	9.268
Itali	11.143	17.548	23.045	33.973	13.708	16.590	24.826	30.099
Spanjë	1.502	150	3.917	940	698	1.291	1.174	1.952
Kroaci	236	719	526	1.025	305	482	582	823
Të tjera të BE-së	2.837	3.279	5.131	6.395	7.108	9.212	12.461	16.192
Mbretëri e Bashkuar	26	96	75	202	389	644	651	1.017
Kinë	778	1.068	1.482	1.806	4.235	4.911	9.123	9.466
Kosovë	2.141	3.380	3.485	6.120	619	1.437	1.159	1.957
Maqedonia e Veriut	496	2.236	909	3.680	754	1.266	1.310	1.868
Rusi	-	-	-	2	684	1.714	1.382	2.251
SHBA	425	374	892	814	1.516	911	2.287	1.702
Turqi	452	263	1.027	635	5.336	7.805	9.719	14.787
Ukrainë	50	56	69	80	380	329	532	1.258
Zvicër	213	510	234	623	627	739	2.117	1.414
Të tjera	1.967	2.201	2.873	4.725	7.044	10.782	14.169	20.609
<b>Gjithsej</b>	<b>24.772</b>	<b>37.291</b>	<b>48.508</b>	<b>72.297</b>	<b>52.247</b>	<b>68.697</b>	<b>97.667</b>	<b>123.712</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Shkurt 2022**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2021	Shkurt 2022	Jan, - Shkurt 2021	Jan, - Shkurt 2022	Shkurt 2021	Shkurt 2022	Jan, - Shkurt 2021	Jan, - Shkurt 2022
<b>Gjithsej</b>	<b>24.772</b>	<b>37.291</b>	<b>48.508</b>	<b>72.297</b>	<b>52.247</b>	<b>68.697</b>	<b>97.667</b>	<b>123.712</b>
Ushqime, pije, duhan	2.720	2.982	5.316	6.314	8.586	10.931	15.713	20.014
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	4.654	9.663	8.228	19.030	3.901	9.857	9.864	18.074
Produkte kimike dhe plastike	700	1.510	1.320	2.790	8.595	9.188	14.599	15.327
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	148	266	290	473	860	1.479	1.561	2.529
Prodhime druri dhe letre	660	1.114	1.277	1.982	1.796	2.375	3.253	4.715
Tekstile dhe këpucë	8.369	10.644	17.668	20.703	6.076	7.425	11.959	13.932
Materiale ndërtimi dhe metale	4.650	7.487	8.899	14.056	7.256	10.849	13.311	20.443
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	2.017	2.758	4.026	5.348	12.480	13.999	23.013	24.331
Të tjera	856	867	1.483	1.599	2.698	2.595	4.393	4.346

**Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shkurt 2022**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
<b>Gjithsej</b>	<b>23.045</b>	<b>33.973</b>	<b>3.485</b>	<b>6.120</b>	<b>2.060</b>	<b>6.885</b>	<b>2.488</b>	<b>3.693</b>
Ushqim, pije duhan	1.602	1.799	472	576	300	327	579	607
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	240	4.658	909	1.667	174	4.316	369	854
Produkte kimike dhe plastike	341	662	357	723	7	6	109	136
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	258	447	1	3	9	0	2	3
Prodhime druri dhe letre	842	1.133	112	285	39	52	157	296
Tekstile dhe këpucë	14.139	16.115	26	22	1.028	1.374	900	908
Materiale ndërtimi dhe metale	2.927	5.510	1.210	2.421	92	400	273	785
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.943	2.807	211	236	350	345	28	15
Të tjera	752	841	188	188	61	64	71	88

**Tab.5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shkurt 2022**

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
<b>Gjithsej</b>	<b>24.826</b>	<b>30.099</b>	<b>9.719</b>	<b>14.787</b>	<b>9.123</b>	<b>9.466</b>	<b>8.000</b>	<b>9.268</b>
Ushqim, pije duhan	3.100	3.973	850	842	141	213	2.244	2.554
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	1.787	1.938	177	499	0	1	1.594	1.837
Produkte kimike dhe plastike	3.204	3.359	1.187	1.593	1.017	921	1.118	1.186
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.263	2.092	45	79	83	102	6	3
Prodhime druri dhe letre	819	1.005	495	733	159	132	464	628
Tekstile dhe këpucë	5.579	7.027	2.362	2.594	1.620	1.539	465	629
Materiale ndërtimi dhe metale	3.194	3.875	2.346	6.296	944	870	1.404	1.720
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	5.141	5.852	1.405	1.468	4.223	4.864	392	491
Të tjera	740	977	852	685	936	824	313	219



# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri